



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS  
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 321 / prot.  
15

Tiranë, më 30.11 .2023

**VENDIM**  
Nr. 46, datë 30.11.2023

**PËR**  
**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN E BRENDSHME TË**  
**SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS**

Në mbështetje të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, i mbledhur më datë 30.11.2023,

**V E N D O S I:**

- I. Të bëhen këto shtesa e ndryshime në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, të miratuar me vendimin nr.1, datë 31.1.2017, i ndryshuar:
  1. Në nenin 66/3 “Departamenti i kërkimeve shkencore dhe botimeve”, shtohet germa “i” me këtë përmbajtje:  
“i) të nxisë dhe promovojë krijimin e hapësirave të diskutimit mes magjistratëve dhe praktikuesve të tjerë të së drejtës nëpërmjet Forumit të Shkollës së Magjistraturës”.
  2. Pas Aneksit 15 shtohet Aneksi 15/2 “Mbi veprimtarinë e Forumit të Shkollës së Magjistraturës”, bashkëlidhur këtij vendimi.
  3. Aneksi 10 dhe Aneksi 10/2, ndryshojnë sipas përmbajtjes bashkëlidhur këtij vendimi.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS  
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 821 / prot.  
16

Tiranë, më 30.11.2023

VENDIM  
Nr. 47, datë 30.11.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 25, DATË 23.10.2017, "PËR  
NORMIMIN DHE SHPËRBLIMIN E VEPRIMTARISË AKADEMIKE,  
NË ZBATIM TË PROGRAMIT TË FORMIMIT FILLESTAR DHE VAZHDUES,  
NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS"**

Mbështetur në nenin 118 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenin 243 dhe 248 të ligjit nr.115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"; në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; në ligjin nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"; në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë"; në nenin 124 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; si dhe të ligjit nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023"; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 748, datë 11.6.2009, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë", ( i ndryshuar), me propozim të Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues, i mbledhur më datë 30.11.2023

**V E N D O S I:**

1. Pika 10, ndryshohet si vijon :

Mësimdhënia e normuar vjetore për personelin akademik me kohë të plotë, e shprehur në orë mësimore e konvertuar në Formimin Fillestar është si më poshtë:

- Për Drejtorin e Shkollës deri në 70 orë ne auditor/ 175 orë e konvertuar
- Për Drejtuesit e Programeve (Fillestar dhe Vazhdues ) 140 orë në auditor/ 350 orë e konvertuar
- Për pedagogët e brendshëm 160 orë në auditor/ 400 orë e konvertuar

- b) Në pikën 11/a, pas togëfjalëshit “20% të orëve” shtohet togëfjalëshi “ mbi normë”
2. Efektet financiare shtrihen për vitin akademik 2023-2024.
  3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.